



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR MIRATIMIN E VËZHguesve AFATGJATË NGA SHOQATA PËR GRATË DHE FËMIJËT, QENDRA KOMBINAT (SHPGF) PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR, 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 12.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

**OBJEKT:** Miratimi i vëzhguesve afatgjatë të paraqitur nga Shoqata për Gratë dhe Fëmijët, Qendra Kombinat për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor, 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

**V Ë R E N**

Shoqata "Për Gratë dhe Fëmijët" Qendra Kombinat (SHPGF) si një nga shoqatat drejtuese të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë, prej 20 vitesh ka vëzhguar dhe monitoruar të gjitha proceset vendore dhe parlamentare.



**Nr. 833 i Vendimit**

**Data 12.06.2019 Ora 13 .<sup>00</sup> e Vendimit**

Miratimi i vëzhguesve afatgjatë nga Shoqata për Gratë dhe Fëmijët, Qendra Kombinat (SHPGF) për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019.

Kjo organizatë ka paraqitur kërkesën e saj me nr. prot. 11110, datë 07.06.2019, bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditimin e 12 (dymbëdhjetë) vëzhguesve afatgjatë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se ai është brenda kushteve dhe kërkesave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4,5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

### **V E N D O S I :**

1. Të miratojë kërkesën e Shoqatës për Gratë dhe Fëmijët, Qendra Kombinat, për akreditimin e 12 (dymbëdhjetë) vëzhguesve afatgjatë për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjen Nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 833 i Vendimit**

**Data 12.06.2019 Ora 13 .<sup>00</sup> e Vendimit**

Miratimi i vëzhguesve afatgjatë nga Shoqata për Gratë dhe Fëmijët, Qendra Kombinat (SHPGF) për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019.